




Planuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received / Delivery	31-05-2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2718/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.334/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2940/2019 i datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.599 e datës 02.10.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Eduard Liri", Nr.95, Prishtinë, kundër Vendimit me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.599 e datës 02.10.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KZKA-11/2019 i datës 29.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

A r s y e t i m

Ankuesja Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datë 02.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4629/2019 të regjistruar me numër A.nr.599/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 08.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(me tutje

MMPH). Këshilli me datë 15.10.2019 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorunit për vendosje, me shkresën me numër protokoli 5168/2018 të datës 05.11.2019 ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 16.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2940/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 02.10.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kolegj për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 599/2019 të datës 02.10.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.06.2019; E-maili nga M.R për M.D. i datës 28.05.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 25.07.2019; E-maili nga A.Ç. për M.D. i datës 24.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.07.2019; Shkresën nga Ambasada e Amerikës e datës 01.07.2019; Kërkesën për miratimin e udhëtimit zyrtar e datës 08.07.2019; Kërkesën për udhëtim zyrtar e

Ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e datës 22.08.2019; Përcjellja e Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 02.09.2019; Vendimin e datës 29.08.2019; Përgjigjen në Ankesë e datës 15.10.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.10.2019; E-maili nga M.L për H.K i datës 14.10.2019; E-maili nga H.K për M.L i datës 14.10.2019; Kërkesën për pushim Vjetor e Procesverbal i datës 26.08.2019; E-maili nga A.Ç. për M.D. i datës 24.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.07.2019; E-maili i datës 23.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 25.07.2019; E-maili nga A.Ç. për M.D. i datës 24.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.06.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 25.07.2019; E-maili nga A.Ç. për M.D. i datës 24.07.2019; E-maili nga M.D. për A.Ç. i datës 24.07.2019; Njoftimin e datës 05.11.2019; ankesën me numër A.nr.599 e datës 02.10.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse,*

Bazuara në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore në MMPH-jë. E njëjta me datë 24.07.2019 i është drejtuar me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, me kërkesën për miratimin e udhëtimit zyrtar për pjesëmarrje në Programin IVLP " Sustainable Water Resource and Waste Menagment" i sponzoruar nga Ambasada Amerikane, dhe i cili do të mbahej nga data 03 deri 23.08.2019, në Shtetet e Bashkuar të Amerikës.

Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së me datë 24.07.2019 përmes emalit zyrtar ka njoftuar ankuesen lidhur me mos miratimin e kërkesës së saj për udhëtim zyrtar, me arsyetimin se e njëjta nuk ka respektuar Udhëzimin Administrativ Nr.MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare.

Ankuesja kundër emalit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së për mos miratim të udhëtimit zyrtar, me datë 22.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe

Ankesave të MMPH-së, i cili organ me Vendimin me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 ka refuzuar ankesën si të pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 të KZKA-së, brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për shkak të shkeljes thelbësore procedurale, shkeljes së ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Me tej, kërkon që Këshilli të anuloi Vendimin me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të MMPH-së që ankueses t'i kompensoj mëditjet për udhëtimin zyrtar në SHBA në datat 03 deri 25.08.2021 si dhe t'ia kthej në dosje personale ditët e pushimit vjetor të shfrytëzuar për udhëtim zyrtar në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore ka analizuar Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, përkatësisht Nenin 3 me të cilin është përcaktuar se: *Kërkesa për udhëtime zyrtare duhet të dorëzohet me së paku pesë ditë pune para shkuarjes në udhëtim zyrtar, përveç rasteve të jashtëzakonshme. Për çdo kërkesë për udhëtim zyrtar duhet zbatuar këto dispozita: i) Të gjithë nëpunësit civilë janë të obliguar që të plotësojnë Formularin e kërkesës për udhëtim zyrtar (shtojca 1), të cilit do t'i bashkëngjitet arsytimi me shkrim, i përkrahur nga udhëheqësi i nëpunësit civil, si dhe ftesa zyrtare e institucionit dhe programi i trajnimit/agjenda e takimit zyrtar. ii) Pas plotësimit të Formularit të kërkesës për udhëtim zyrtar, nga nëpunësi civil i cili udhëton dhe pas miratimit të udhëtimit zyrtar nga udhëheqësi i nëpunësit civil, kërkesa i dorëzohet shërbimit të personelit. iii) pas verifikimit të të dhënave nga shërbimi i personelit, i cili në listën e vijimit të punës do të shënoj udhëtimin zyrtar, ajo do t'i dorëzohet Sekretarit të Përhershëm/Kryeshefit Ekzekutiv të Ministrisë përkatëse për miratim, ... vi) Formulari i kërkesës për udhëtim zyrtar dhe vendimi i Sekretarit të Përhershëm/Kryeshefit Ekzekutiv, duhet të dorëzohet Shërbimit për Buxhet dhe Financa..., ndërsa neni 4 i po të njëjtit Udhëzim Administrativ ka përcaktuar se: **Nuk mund të realizohet asnjë udhëtim zyrtar pa vendim të nxjerrë Sekretari i Përhershëm i ministrisë përkatëse ose nga Kryeshefi Ekzekutiv përkatës.***

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja më rastin e aplikimit për pjesëmarrje në Programimin IVLP "Sustainable Water Resource and Waste Menagment" nuk ka marrë paraprakisht miratim nga mbikëqyrësja e saj e drejtpërdrejt, e të cilin fakt e ka pohuar edhe vet Udhëheqësja e ankueses përmes deklaratës me shkrim të datës 14.10.2019. Po ashtu ankuesja për këtë udhëtim zyrtar nuk ka marrë paraprakisht edhe aprovimin e Sekretarit të Përgjithshme, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson së pretendimet ankimore të ankueses që ti kompensohen mëditjet për udhëtimin zyrtar në SHBA në datat 03-25.08.2021 si dhe t'i kthehen ditët e pushimit vjetor të shfrytëzuara, janë të pa bazuara.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Vendimin me numër KZKA-11/2019 të datës 29.08.2019 ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankueses të datës 22.08.2019 dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr.334/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së